

# SI TË PËRFSHIHEMI NË VENDIMMARRJEN LOKALE DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJINË



## Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë



Mbledhjet e këshillit të bashkisë tashmë transmetohen edhe online. Nëse nuk mund të merrni pjesë fizikisht, ju mund t'i ndiqni nëpërmjet faqeve të bashkisë. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në faqen web të bashkisë dhe rrjetet sociale dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Vizitoni faqet web të bashkive tuaja për të ndjekur fizikisht apo virtualisht mbledhjet e këshillave bashkiake.

## E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes



Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksionet dhe kompetencat në juridiksionin e njësive të vetë-qeverisjes vendore. Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativë qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësive të vetë qeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak. Ja se si mund të paraqesni një kërkesë apo ankesë në Bashkinë Durrës **Model kerkese dhe ankesa**

## Shkruaji Kryetarit



Një rubrikë që përdoret shpesh është **Shkruani Kryetarit të Bashkisë**. Në këtë rubrikë mund t'i shkruani kryetarit të bashkisë suaj me shqetësimin, ankesën apo kërkesën që keni. Mesazhi juaj do të dërgohet dhe ju do të merrni përgjigje brenda 24 orëve. Ndiqui modelin e Bashkisë Shijak **Shkruaji Kryetarit** mbi mënyrën se si mund t'i drejtoni një kërkesë, sugjerim apo ankesë kryetarit të Bashkisë.

## Peticionet



Peticioni është një mekanizëm i rëndësishëm i demokracisë pjesëmarrëse pasi inicohet nga publiku, në dallim me informimin dhe konsultimin publik që janë detyra të bashkisë. E drejta e peticionit është e parashikuar në nenin 48 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj. Peticionet online ju mundësojnë t'i nënshkruani ato apo t'i mbështesni nismat e nisma duke plotësuar të dhënat e kërkuara. Janë një mënyrë e thjeshtë se si mund të mbështesni iniciativat të ndryshme. Në portalin **qytetarIN** do të gjeni një sërë petitionesh aktive dhe iniciativash të realizuara. Do të keni mundësinë edhe të inicioni vetë një petition. **Ky portal është i fokusuar në Bashkinë Tiranë, Durrës dhe Kurbin**. Gjithashtu, në faqen e Bashkisë Shijak mund të merrni informacion të përmbledhur se si të parashtroni një petition me shkresë dhe në formë elektronike. **Model Peticioni**

**Merr pjesë,  
përmirëso demokracinë!**

